

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN FARKË TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Farkë, Tiranë**, me objekt: “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, prokurimi i fondeve publike për mallra dhe shërbime, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejet e shfrytëzimit të objekteve, menaxhimin e administrimin e aseteve, etj.”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.11.2011 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 55, datë 02.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 52/8, datë 02.06.2014, i ka rekomanduar z. Bardh Plaku, Kryetar i Komunës Farkë, Tiranë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Në hartimin e buxhetit për vitin 2014 të përfshihen detyrimet afat shkurtër ndaj të tretëve të rezultuara nga mbyllja e bilancit kontabël, në shumën 24,261 mijë lekë, sipas kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “*Për buxhetin e vitit 2013*”.

Menjëherë

2. Nga Drejtoria e Financës të merren masa, që të hapen librat analitik të magazinës, centralizatori (libri i madh) dhe ditari i veprimeve të ndryshme, sipas kërkesave të pikës 8 c të nenit 3, pikën 1, 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, kapitulli III, pika 35 c.

Menjëherë

3. Nga Drejtoria e Financës të merren masa, që mandatarkëtimet të nënshkruhen nga personi që kryhen derdhjen, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, kapitulli III, pika 68 a.

Menjëherë

4. Nga Drejtoria e Financës të merren masa, që inventarizimi fizik i vlerave monetare në arkë të kryet minimalisht një herë në muaj, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, kapitulli IV, pika 80.

Vazhdimisht

5. Nga Drejtoria e Financës të merren masa, që dalja e aktiveve nga magazina të bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletë kërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, kapitulli III, pika 35c, 38 dhe 40.

Menjëherë

6. Nga Drejtoria e Financës të merren masa, që për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara si: Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” me vlerë 50,734,800 lekë; Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” me vlerë 60,738,740 lekë; Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” me vlerë 219,048,784 lekë; Llogaria 213 “Rrugë, mjete, vepra ujore” me vlerë 1,399,920 lekë; Llogaria

214 “Instalime, makineri pajisje e vegla pune” me vlerë 10,530,307 lekë; Llogaria 215 “Mjete transporti” me vlerë 18,776,600 lekë, të hapen kartela për çdo aktiv ku të pasqyrohen data e hyrjes apo marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, sipas kërkesave të pikës 3. dh të nenit 12, pikën 2 të nenit 16 dhe pikën 5 të nenit 23, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III, pika 30.

Menjëherë

7. Nga Drejtoria e Financës të merren masa, që të pasqyrohen në kontabilitet detyrimet e llogarisë 401-408 “Furnitorë llogari të lidhura me to” në shumën prej **20,515,436 lekë** e konkretisht:

- a. Shërbim për programin e ujësjellësit, për muajin nëntor 2012 në shumën 13,459 lekë.
- b. Detyrimi i sipërmarrjes së ujësjellësit, për muajin Gusht viti 2012 në shumën 1,088,553 lekë, muaji Shtator viti 2012 në shumën 1,084,334 lekë, muaji Nëntor 2012 në shumën 1,099,512 lekë.
- c. Detyrimi i sipërmarrjes së ujësjellësit, për muajin Dhjetor viti 2012 në shumën 924,595 lekë.
- d. Detyrimi për energjinë elektrike për muajin nëntor, dhjetor viti 2012 në shumën 298,277 lekë.
- e. Detyrimi postar për muajin dhjetor viti 2012 në shumën 48,420 lekë. Paguar me urdhër shpenzimit nr. 7, datë s’ka 48,420 lekë.
- f. Detyrimi i sipërmarrjes së pastrimit, për periudhën 01.5.2012 – 31.12.2012 viti 2012, gjithsej 8 muaj në shumën 15,883,286 lekë, sipas kërkesave të nenit 3 dhe nenit 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; pikën 3 dh të nenit 12, pikën 2 të nenit 16 dhe pikën 5 të nenit 23, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III, pika 35.

Menjëherë

8. Nga Drejtoria e Financës të merren masa, që të kryhet inventarizimi i aktiveve afatgjata, të krahasohet me gjendjen kontabile dhe të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme, sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV, pika 74.

Brenda 9 mujorit 2014

9. Në rastet e marrjes në dorëzim të punimeve të ndërtimit, shërbimeve të kryera dhe marrjes së mallrave e materialeve në dorëzim, të ngihet një komision me urdhër të veçantë, me të paktën 3 specialistë të fushës, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Vazhdimisht

10. Nga Njësia e Prokurimit të cilësohet në dokumentet e tenderit kërkesa që operatorët ekonomikë të paraqesin vërtetim për shlyerjen e taksave e tarifave vendore në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku ato kanë seli dhe zhvillojnë veprimtarinë.

Vazhdimisht

11. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejt kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organe kompetente.

Vazhdimisht

12. Nga Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të merren masa për hartimin e planit vjetor të kontrolleve në drejtimet e përcaktuara, sipas kërkesave të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”, pika 10, “Kontrolli tatimor”.

Brenda 9 mujorit 2014

13. Në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit, titullari i njësisë publike (Komunës), të hartojë politikat, të miratojë dhe monitorojë objektivat e njësisë publike që ai drejton, planet strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave. Të ngrihet grupi i menaxhimit strategjik të njësisë publike, i cili të përbëhet nga titullari i njësisë publike dhe të kryesohet prej tij sipas ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Brenda 9 mujorit 2014

14. Nga Komuna të miratohet një sistem i rregullave specifike të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. III.

Brenda 9 mujorit 2014

15. Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për cdo rast, përpara lëshimit të lejes së përdorimit të objektit ndërtimor të vlerësohet zbatimi i VKM nr. 480, datë 22.6.2011, neni 10 “Kushtet për zhvillim”, pika 11 e cila përcakton se “Infrastruktura e nevojshme që mundëson funksionimin e një zhvillimi të ri dhe e lidh zhvillimin e ri me rrjetet ekzistuese të infrastrukturave, realizohet nga zhvilluesi dhe leja e përdorimit jepet vetëm pasi kjo infrastrukturë regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme...”.

Vazhdimisht

16. Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për cdo rast pas lëshimit të lejeve të përdorimit të veprohet me inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve në zyrën e Protokoll/Arkivit në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe rregullorja e nxjerrë në zbatim të tij.

Vazhdimisht

17. Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për cdo rast, përpara lëshimit të lejes së përdorimit të objektit ndërtimor të bashkëpunohet me Sektorin e Tatim Taksave dhe INUV si dhe të bëhet pjesë e dosjes së objektit, dokumenti (vërtetimi) se subjekti ka shlyer apo nuk ka detyrime lidhur me pagesën e taksave vendore si dhe ka apo nuk ka shlyer detyrimet ndaj INUV lidhur me gjobat e vendosura apo tarifat e shërbimit.

Vazhdimisht

18. Nga Komuna Farkë, të veprohet menjëherë për plotësimin e organikës së strukturës së Policisë Komunare, duke bërë emërimin e punonjësve të policisë sipas pikës 2 të nenit 11 të urdhrat të përbashkët të MPVD nr. 1530 datë 07.4.2003” dhe MRP, nr. 823 datë 11.4.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës”, pasi një pjesë e emërimeve është bërë pa kryer formimin në Akademinë e Rendit Publik.

Brenda vitit 2014

19. Nga Policia Komunare Farkë të veprohet për cdo rast me plane pune të planifikuara në zbatim të ligjit, si dhe të ndërmerren të gjitha masat e duhura lidhur me bashkëveprimin dhe dokumentimin e procedurave të kryera nga kjo strukturë si në bashkëpunimin rutinë me strukturat e tjera brenda komunës, ashtu dhe me institucionet e tjera jo në varësi të komunës.

Vazhdimisht

20. Nga Policia Komunare të bëhen të gjitha përpjekjet ligjore administrative dhe gjyqësore në lidhje me arkëtimin e plotë të gjobave të papaguara, të vendosura mbështetur në VKK nr. 37, datë 08.06.2010 “Mbi vendosjen e gjobave dhe bllokuesve të mjeteve nga Komuna Farkë”, në total **210,000 lekë**, nga ku për vitin 2012 nuk janë arkëtuar **120,000 lekë** dhe për vitin 2013 shuma prej **90,000 lekë**.

Brenda vitit 2014

21. Nga Komuna Farkë, të veprohet menjëherë për plotësimin e organikës së strukturës së INUV të Komunës Farkë, duke bërë emërimin e punonjësve të saj sipas sipas kritereve të përcaktuara në nenin 11, “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit ndërtimor urbanistik” të ligjit nr. 9780 datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, pasi dy prej

punonjësve nuk gëzojnë arsimin e nevojshëm profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës etj.

Brenda vitit 2014

22. Nga INUV Komuna Farkë, të vepohet menjëherë për zbatimin e 5 vendimeve të nxjerra po nga kjo strukturë lidhur me prishjen e objekteve ndërtimore të ngritura pa leje ndërtimi, në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2011 “Për Inspektimin e ndërtimit”.

Brenda vitit 2014

23. Nga INUV Komuna Farkë, të bëhen të gjitha përpjektet ligjore administrative dhe gjyqësore në lidhje me arkëtimin e plotë të gjobave të papaguara dhe të pa kontabilizuara, në total **14,841,470 lekë**, nga ku për vitin 2012 vlera e pa arkëtuar është **3,250,000 lekë** ndërsa për vitin 2013 është **11,591,470 lekë**, për të cilat është konstatuar se nuk janë ndjekur procedurat e plota ligjore për vjeljen e tyre, si të ardhura të munguara në buxhet, duke vepruar në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe me nenin 22, me pikën 4/a të nenit 30, të ligjit nr. 10279, “Për Kundërvajtjet Administrative”.

Brenda vitit 2014

24. Nga INUV Komuna Farkë, për cdo rast të vepohet duke programuar planifikuar ushtrimin e kontroleve të rregullta periodike në drejtim të zbatimit të lejeve të ndërtimit të dhëna nga drejtoria e planifikimit, lidhur me periudhën që rezulton se subjekti ka filluar punimet, periudhën kur ka përfunduar fazën karabina, për të gjithë periudhën që nga fillimi i punimeve deri në fund, pra duke bërë inspektime për të kontrolluar zbatimin e punimeve të ndërtimit, referuar kërkesave të nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”.

Vazhdimisht

25. Nga INUV Komuna Farkë, për cdo rast të vepohet duke mbajtur një regjistër të brendshëm dhe duke krijuar një praktikë të protokollimit të ankimimeve, sipas referimeve të nenit 81 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” dhe neni 10 “Përgjegjësi i Sektorit” dhe 30 pika “Inspektorati Ndërtimor i Komunës” dhe nënpika “Detyrat e Kryeinspektorit” të Rregullores së brendshme të komunës, duke synuar dhe ndikuar drejtpërdrejt në rritjen efektivitetit dhe transparencës së veprimtarisë së INUV Komuna Farkë.

Vazhdimisht

26. Nga INUV Komuna Farkë, për cdo rast të vepohet duke ngritur një sistem bashkëveprimi dhe bashkërendimi të veprimeve të INUV dhe Drejtorisë të Planifikimit të Territorit por dhe strukturave të tjera, në referim të nenit 81 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, duke synuar dhe ndikuar drejtpërdrejt në parandalimin e uljen e riskut të zhvillimit të ndërtimeve të paligjshme në territorin e komunës.

Vazhdimisht

27. Nga INUV Komuna Farkë, për cdo rast lidhur me administrimin e dosjeve të punës të vepohet me inventarizimin dhe arkivimin e tyre në zyrën e Protokoll/Arkivit në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe rregullorja e nxjerrë në zbatim të tij.

Vazhdimisht

28. Nga INUV Komuna Farkë, lidhur me kalimin e afateve procedurale ligjore të zbatimit të vendimeve të marrë nga INUV, për të cilat nuk janë ndërmarrë masat e veprimet për zbatimin e procedurave të mëtejshme ligjore, të vepohet në referim të plotë të neneve 4, 5 dhe 13 të ligjit nr. 7980, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” dhe nenit 83 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.

Menjëherë

29. Nga Komuna Farkë, të merren masa për detyrimin e personit fizik G.P që të plotësojë detyrimin kontraktual për mbjelljen e pemëve dekorative, të cilat nuk kanë rezultuar me zënie sipas kontratës.

Brenda muajit Shtator 2014

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Komuna Farkë të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën 4,682,950 lekë si më poshtë:

1- Shuma prej **624,000 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar nga firma “R...” sh.p.k. për mos sjelljen e Rërës Bituminoze dhe transportin e sajë në komunën Farkë. Veprim në kundërshtim me pikat 35, 36, 37,38,39, dhe 40 të Kreut të III-të të UMF nr. 30 datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit Publik” , si dhe me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit “ neni nr. 8 dhe 11, me Kreun I- rë pikën 8.3 të UKM, nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, me udhëzimin e UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Brenda 9 mujorit 2014

2- Shuma prej **215,000 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar nga:

- I.A. dhe M.M. për diferencën e fidanëve të Eukalipti për 430 copë **në vlerën 172,000 lekë**.
- Për mos kryerjen e shërbimit, hapje gropash dhe mbjellje fidani Eukalipti për 430 copë **në vlerën 43,000 lekë**, nga I.A. 14,333 lekë, K.A. 14,333 lekë dhe F.Sh. 14,333 lekë.

Brenda 9 mujorit 2014

4- Shuma prej **125,000 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar nga firma firmës “ M...A.. ” sh.p.k., për përfitim të pa drejtë të transportit të materialeve inerte i cili është mbi kapacitetin e mjetit transportues në kundërshtim me ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit “ neni nr. 8 dhe 11, me Kreun I- rë pikën 8.3 të UKM, nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, me UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Brenda 9 mujorit 2014

5. Në **shumën 115,640 lekë (pa TVSH)**, nga **Shoqëria “B...” sh.p.k**, pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, të kontratës së blerjes së karburantit rezultojnë diferenca në çmimin e zbatuar dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

Brenda 9 mujorit 2014

6. Në **shumën 120,762 lekë (pa TVSH)**, nga **Shoqëria “E...” sh.p.k**, pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, të kontratës së blerjes së karburantit rezultojnë diferenca në çmimin e zbatuar dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

Brenda 9 mujorit 2014

7. Në **shumën 116,026 lekë (pa TVSH)**, nga **Shoqëria “B...-I...” sh.p.k**, pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Kompletimi i ndërtimit të pusetave dhe instalimit të matësave të ujit” rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

Brenda 9 mujorit 2014

8. Në **shumën 1,025,268 lekë (pa TVSH)**, nga **Shoqëria “F...” sh.p.k**, pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Rikonstruksion(Asfaltim) Rruge, Farkë e Vogël-Qendër-Shkolla Farkë” rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

Brenda 9 mujorit 2014

9. Në **shumën 286,201 lekë (pa TVSH)**, nga **Shoqëria “E...K...” sh.p.k**, pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Ndërtim i

Rrugës Selitë, Segmenti Eleonore-Rruga e Zallit” rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

Brenda 9 muhorit 2014

10. Në shumën 394,016 lekë (pa TVSH), nga **Shoqëria “F...” sh.p.k**, pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Rikonstruksion Rruge, Lokal Bluri-Varrezat (Lagja e Agallarëve)” rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

Brenda 9 muhorit 2014

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kontratën individuale të punës, kërkojmë nga Kryetari i Komunës, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

a. Zgjidhja e kontratës të punës, për:

1. M.M. me detyrë Magazinier, pasi:

Ka bërë hyrje, me fletë hyrjes nr. 41, datë 15.08.2012, Rrën Bituminoze, por pa ushtruar kontroll në sasinë e mallit të ardhur. Mallin e ardhur nuk e ka bërë dalje, ku në fakt në Komunë kanë ardhur 350 tonë, janë kryer veprime fiktive për 650 tonë rrë bituminoze duke shkaktuar një dëm buxhetit të shtetit në vlerën 624,000 lekë. Veprim që ngarkon me përgjegjësi Përgjegjësen e Financës dhe Magazinierin që kanë kryer veprimet në kundërshtim me kundërshtim me pikat 35, 36, 37,38,39, dhe 40 të Kreut të III-të të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30 datë 27.12.2011” Për Menaxhimin Financiar në njësit e sektorit Publik”

-Ka marrë në dorëzim duke bërë hyrje dhe dalje në mënyrë fiktive pa kontrolluar materialet e ardhura nga të tretët, si për prurjen e 1000 fidanëve Ekualips, ku kanë rezultuar 430 fidanë më pak. Duke shkaktuar një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën **215,000 lekë**. Veprimet e më sipërme janë në kundërshtim me pikat 35, 36, 37,38,39, dhe 40 të Kreut të III-të të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30 datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit Publik”

Ka marrë në dorëzim duke bërë hyrje dhe dalje në mënyrë fiktive pa kontrolluar materialet e ardhura nga të tretët, për materialet inerte të çakullit dhe rrës e stabilizant mbi kapacitetin maksimal të transportit të mjetit veprim që ka sjellë një dëm ndaj buxhetit të shtetit në **vlerën 125,000 lekë**

Nga ana e vetë magazinierit deklarohet se: Komuna nuk ka magazinë, si rrjedhojë mallrat dhe materialet nuk magazinohen por shkojnë direkt në destinacion. Veprimet hyrje – dalje bëhen në mënyrë fiktive, në bazë të dokumentit të ardhur nga institucioni që ka bërë daljen e mallit, kur vjen malli unë e dërgojë direkt në destinacion dhe dokumentacioni që sjell mallin firmoset nga përfaqësuesi i komunës.

-Ka kryer veprime dalje të materialeve nga magazina pa urdhër të titullarit apo të personit të autorizuar prej tij, dhe pa adresë se kujt i është bërë dalje ky material.

2. M.N. me detyrë Kryeinspektor i INUV, pasi:

Janë marrë 23 vendime për prishje të objekteve pa leje, por nga këto nuk janë zbatuar 5 vendime, veprim në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2011 “Për Inspektimin e ndërtimit”.

Nuk janë ndjekur procedurat e plota ligjore për vjeljen e gjobave, për rrjedhojë arkëtimi i tyre rezulton të jetë në nivele shumë të ulëta dhe konkretisht për vitin 2012 vlere e pa arkëtuar është 3,250,000 lekë dhe për vitin 2013 vlere e pa arkëtuar është 11,591,470 lekë, ose në total

14,841,470 lekë, që përbën të ardhura të munguara në buxhet, veprim ky në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe me nenin 22, me pikën 4/a të nenit 30, të ligjit nr. 10279, “Për Kundërvajtjet Administrative”.

Nuk janë ushtruar kontrole të rregullta në drejtim të zbatimit të lejeve të ndërtimit të dhëna nga urbanistika, si p.sh. lidhur me periudhën që rezulton se subjekti ka filluar punimet, periudhën kur ka përfunduar fazën karabina, për të gjithë periudhën që nga fillimi i punimeve deri në fund, pra nuk janë bërë inspektime për të kontrolluar zbatimin e punimeve të ndërtimit, veprim në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” .

Nuk ka një regjistër dhe një praktikë protokollimi të ankimimeve, duke mos u zbatuar plotësisht pika 4 e nenit 81 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” dhe neni 10 “Përgjegjësi i Sektorit” dhe 30 pika “Inspektorati Ndërtimor i Komunës” dhe nënpika “Detyrat e Kryeinspektorit” të Rregullores së brendshme të komunës, duke ndikuar në uljen e efektivitetit dhe transparencës së veprimtarisë së INUV Komuna Farkë.

Aktiviteti i INU nuk ka funksionuar në bazë të planeve mujore duke mos u zbatuar plotësisht germën “b” paragrafi “ii”, të pikës 1 të VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit të Territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor”.

Nuk ka një bashkëveprim dhe bashkërendim të veprimeve të INU dhe Sektorit të Planifikimit të Territorit e strukturave të tjera, duke mos zbatuar pikën 3 të nenit 81 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, kjo ndikon në rritjen e riskut të zhvillimit të ndërtimeve të paligjshme në territorin e komunës.

Janë mbajtur dosjet e Inspektoratit ndërtimor Urbanistik, por nuk janë inventarizuar plotësisht dhe nuk janë dorëzuar në zyrën e arkivit, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Nuk janë bërë analiza vjetore për aktivitetin e kryer dhe nuk janë hartuar raporte vjetore të aktivitetit të INUV-it, duke mos u zbatuar pika 5 të nenit 81 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.

Konstatohen disa raste se megjithëse ka kaluar afati i zbatimit të vendimeve të marrë nga INUV, nga kjo e fundit nuk është ndërhyrë për zbatimin e procedurave të mëtejshme ligjore në zbatim të neneve 4, 5 dhe 13 të ligjit nr. 7980, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” dhe nenit 83 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.

b. “Kalim në një detyrë të një niveli apo klasë më të ulët,” bazuar në Kontratën individuale të punës neni 13 germa (c).

1. I.A. me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të Pastrim Gjellbërimit dhe Mirëmbajtjes të Rrugëve, pasi:

-Ka marrë në dorëzim duke firmosur fletë daljet e shitësit për blerjen dhe transportin e Rërës të Zezë Bituminoze në sasinë 1000 tonë. Në fakt në Komunë kanë ardhur = 350 tonë, janë kryer veprime fiktive për 650 tonë në vlerën 624,000 lekë.

-Ka marrë në dorëzim duke firmosur fletë daljet e magazinës për materialet inerte të çakllit dhe rërës mbi kapacitetin maksimal të transportit të mjetit veprim që ka sjell një dëm ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 125,000 lekë. Veprimet e më sipërme janë në kundërshtim me pikat 35, 36, 37,38,39, dhe 40 të Kreut të III-të të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30 datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit Publik”, si dhe me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit “ neni nr. 8 dhe 11, me Kreun I- rë pikën 8.3 të UKM, nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, me udhëzimin e UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

2. Z.K. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës, pasi:

-Ka lejuar që mallrat dhe materialet e ardhura nga të tretët të mos magazinohen, por të shkojnë direkt në destinacion. Veprimet hyrje – dalje bëhen në mënyrë fiktive, në bazë të dokumentit të ardhur nga institucioni që ka bërë daljen e mallit. Veprimet e më sipërme janë në kundërshtim me pikat 35, 36, 37,38,39, dhe 40 të Kreut të III-të të UMF nr. 30 datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit Publik”,

-Ka lejuar si Drejtore Finance por dhe si Kryetare e komisionit të blerjeve të vogla që Komisioni në asnjë rast nuk ka lënë gjurmë për testimin e tregut, pra nuk ka asnjë dokumentacion që të faktojë që komisioni ka testuar tregun duke kryer veprime vetëm me një subjekt. Veprim në kundërshtim me. pika 1, 2, 4 dhe pika 5 UKM nr. 2 datë 18.02.2008. “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”

-Ka lejuar duke mos kryer tender për, blerjen e pemëve, mbjellja e tyre dhe shërbimet e kryera në pemët e kësaj komune zënë vlerën 1,200,000 lekë, patjetër duhet të ishte zhvilluar procedurë për tenderim, mos kryerja e tenderit dhe copëtimi i tyre bie ndesh me nenin 28, pika 2 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike”

-Ka lejuar që materialet e ardhura si pjesë këmbimi të blera pranë servis “Shima” duhet të bëheshin hyrje në magazinë dhe pastaj të bëheshin dalje. Veprim në kundërshtim me pikat 35, 36, 37, 38, 39, dhe 40 të Kreut të III-të të UMF nr. 30 datë 27.12.2012 “Për menaxhimin financiar në njësitë e sektorit publik”

c. “Vërejtje me paralajmërim”, bazuar në Kontratën individuale të punës neni 13 qerma (b).

1. K.A. me detyrë arkitekt pranë Drejtorisë të Urbanistikës.

2. F.Sh. me detyrë topograf, pranë Drejtorisë të Urbanistikës, pasi:

Kanë hartuar procesverbale për verifikimin dhe marrjen e punës në dorëzim për prurjen dhe punimet që janë bërë për mbjelljen e 1000 fidanëve Eukalpt në rrugët e kësaj komune. Në fakt shërbimet janë kryer për 570 fidanë, duke kryer shërbime fiktive për 430 fidanë, duke shkaktuar një dëm ekonomik ndaj buxhetit të komunës në shumën **215,000 lekë**. Veprimet e më sipërme janë në kundërshtim me pikat 35, 36, 37,38,39, dhe 40 të Kreut të III-të të UMF nr. 30 datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit Publik”

- Kanë hartuar proces verbale për verifikimin dhe marrjen e punës në dorëzim për blerjen dhe transportin e Rërës të Zezë Bituminoze 1000 tonë. Në fakt në Komunë kanë ardhur = 350 tonë, janë kryer veprime fiktive për 650 tonë rërë bituminoze duke shkaktuar një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 624,000 lekë.

- Kanë hartuar proces verbale për verifikimin dhe marrjen e punës në dorëzim për materialet inerte të çakllit dhe rërës mbi kapacitetin maksimal të transportit të mjetit veprim që ka sjell një dëm ndaj buxhetit të shtetit në **vlerën 125,000 lekë**. Veprimet e më sipërme janë në kundërshtim me pikat 35, 36, 37,38,39, dhe 40 të Kreut të III-të të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30 datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit Publik”, si dhe me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit “ neni nr. 8 dhe 11, me Kreun I- rë pikën 8.3 të UKM, nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, me udhëzimin e UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

3. B.B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë të Zyrës së të Ardhurave Vendore

4. Sh.T. me detyrë inspektor i Zyrës së të Ardhurave Vendore, pasi:

-Nuk kanë ushtruar kontrolle për mbajtjen e saktë të librave dhe mbajtjen e xhiros, në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

-Nuk ka aplikuar gjoba në masën 5-25 për qind, ndaj subjekteve të cilët nuk kanë paguar në afat detyrimet tatimore, në kundërshtim me nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ” Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

-Nuk i kanë dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive për subjektet debitorë të biznesit të vogël, në kundërshtim me nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

-Nuk ka kërkuar vendosjen e bares siguruese, për subjektet e biznesit të vogël debitorë, përkatësisht: Drejtorisë Rajonale të Transportit (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit të Paluajtshme (për pasurinë e paluajtshme), në kundërshtim me nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

- Nuk janë nxjerrë listat për subjektet debitor dhe familjeve që kanë përfituar tokë, për pagesën e detyrimeve dhe nuk i janë dërguar zyrtarisht Policisë të komunës dhe Zyrës së Financës.

- Nuk i është kërkuar Këshillit të Komunës Farkë ndërhyrje me forcë e Policisë të komunës, për vjeljen e subjekteve debitorë dhe familjeve që kanë përfituar tokë, siç parashikohet në nenin 5, germa "ç" nën-pika "iii", të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".

- Nuk kanë bërë përpjekje për arkëtimin e taksës për token bujqësore në shumën 8,715 mijë lekë nga 1995 familje të Komunës Farkë .

- Nuk kanë bërë përpjekje për arkëtimin e detyrimeve tatimore nga 17 subjekte të biznesit të madh, në vlerën 737 mijë lekë,

Veprime në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Komunës", miratuar me Vendim të Këshillit të Komunës, nr. 7, datë 11.02.2013, me Kreun V. Organizimi dhe funksionimi i drejtorive neni 30 -Detyrat e sektorit të ardhurave lokale,

5. Sh.K. me detyrë Kryeinspektor i Policisë Komunare, pasi:

Për vitin 2012 nga policia e komunës janë vendosur gjoba për shkelje të ndryshme por nuk janë arkëtuar 120,000 lekë, ndërsa për vitin 2013 mbetet për tu arkëtuar 90,000 lekë ose 27 përqind e vlerës. Në total vlera e gjobave të mbetura për tu arkëtuar është 210,000 lekë.

Nga Policia në bashkëpunim me Zyrën e Tatim/Taksave nuk ka dokumentuar kontrollet e ushtruar mbi territorin nën administrim të saj edhe pse rezulton se vjelja e të ardhurave vendore është në masën mbi 90%, por kjo strukturë nuk ka evidenca të subjekteve të licencuara dhe të palicencuara.

Nisur nga konstatimi se nuk ka akte evidentimi për subjektet të cilat ushtrojnë aktivitetin brenda territorit nën administrim të komunës nga Policia Komunare dhe Zyra e Tatim/Taksave, për subjektet të cilët mund të operojnë në treg të peregjistruara nuk është vepruar sipas pikës 2/a të nenit 49 "*Shkeljet dhe dënimet në lidhje me regjistrimin*" të ligjit nr. 8560 datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore" ku sanksionohet se: "*kryerja e veprimtarisë pa u pajisur më parë me certifikatën tatimore, dënohen...*", po ashtu edhe ndaj subjekteve të cilët nuk kanë paguar taksat brenda afatit, nuk është aplikuar gjobë në masën 20% të detyrimit të taksës, sipas kërkesave të nenit 17 pika 1/a "*Kundërvajtjet dhe sanksionet*", të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i cili sanksionon se: "*mospagimi i taksës brenda afatit të caktuar dënohet me gjobë të barasvlershme me 25 për qind të detyrimit për taksën*".

Nga Policia dhe Zyra e Tatim/Taksave nuk rezulton të jenë propozuar apo aplikuar gjoba për personat e palicencuar apo me detyrime të papaguara, po ashtu Policia nuk ka mbajtur procesverbal apo dokument tjetër për evidentimin e subjekteve pa leje apo pagesën e detyrimeve fiskale, duke mos mundur kështu rritjen e subjekteve tatim paguese, pra për rrjedhojë dhe rritjen e të ardhurave të komunës, detyrim që rrjedh nga pika 9 e nenit 8 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, i cili përcakton se Policia e Komunës ka për detyrë të inspektojë respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shitblerjes në mjediset publike.

Policia nuk ka dokumentuar veprimet për parandalimin dhe masat për shmangien dhe prishjen e ndërtimeve të paligjshme si dhe të ndalimin e zënien e paligjshme të trojeve, ndërtesave dhe të objekteve, të kryera në bashkëpunim me Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik kur rezulton se nga INUV i komunës janë mbajtur procesverbale kontrolli dhe konstatimi edhe pse jo në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2009 "Për inspektimin e ndërtimit".

6. V.Ç. me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit,
7. A.M. me Detyrë N/Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit
8. G.V. me detyrë Sekretare Teknike dhe
9. E.Gj. me detyrë specialist/arkitekt, pasi:

Lidhur me vendimin nr. 48, datë 01.10.2013 i cili ka miratuar dhënien e lejes zhvillimore të ndërtimit për objektin **“Objektin nr. 2 Objekt Banimi dhe Shërbimi 6.5 kt + 1kt Podrum”** për subjekt ndërtues dhe investitor shoqërinë “Shehu Construction” sh.p.k., është konstatuara se:

Koeficienti i shfrytëzimit të tokës është marrë 48% me sipërfaqe 296 m², dhe jo 45% me sipërfaqe 277.2 m². Ky veprim është në kundërshtim me Rregulloren Vendore të Planifikimit të Territorit të Komunës Farke, Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit, nr. 18 datë 10.05.2013, ku në kreun e dytë “Rregulla mbi intensitetin e zhvillimit dhe treguesit e zhvillimit për çdo nënjesi strukturore” për nënjesinë strukturore Selitë 22-7, pika 7 thuhet se “Koeficienti i shfrytëzimit të tokës shkon deri 45%”. Sa më sipër sipërfaqja e shfrytëzimit duhej të ishte 277.2 m² dhe jo 296 m².

Nuk janë respektuar distancat e objektit nga bordura e rrugës ku në zbatim të pikës nr. 66 të VKM VKM nr. 502, datë 13.07.2011 *“Për miratimin e rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit”* e ndryshuar për rrugë me gjerësi deri 7 metër distanca duhet të jetë jo më pak se 5 metër.

Lidhur me vendimin nr. 5 datë 29/09/2011 të KRRT-së, i cili ka miratuar leje ndërtimi për *“Godinë banimi dhe shërbimesh 3 me 2 kat podrum dhe nënçati”*, në pronë të trashëgimtarëve të Shukrane Muda, me firme ndërtuese “Edil-Max”, është konstatuara se:

Në dosje nuk është leja e zbardhur pasi taksa e prerë me shumën 50 248 lekë nga zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit është e papaguar, por ndodhet vetëm vendimi i miratimit nr.3 datë 25.07.2012.

Për objektin **“Kompleks vilash 2 kate me nënçati dhe podrum”**, fshati Mjull Bathore, Komuna Farkë me leje ndërtimi nr. 455, datë 20.03.2005 dhënë nga mbledhja e KRRT-së nr. 11, datë 28.10.2005, me subjekt ndërtues **“Vista Group” sh.p.k.**, me sipërfaqe prone prej 2300 m² dhe sipërfaqe ndërtimi prej 387 m², lëshuar leje përdorimi me nr. 1314, datë 19.06.2012, është konstatuara se:

Pagesa është bere pas protokollimit te lejes se përdorimi.

Për objektin **“Qendër arsimore, kompleks banimi dhe shërbimi 2,3 dhe 5 kate me nënçati dhe 2-3 kate podrum”**, fshati Selitë, Komuna Farkë me leje ndërtimi nr. 1303, datë 06.08.2010 dhënë nga mbledhja e KRRT-së nr. 5, datë 09.06.2010, me subjekt ndërtues **“Astir Group” sh.p.k.(Rikonfigurim i sheshit dhe lejes)**, me sipërfaqe prone prej 2969 m² dhe sipërfaqe ndërtimi prej 1580 m², lëshuar leje përdorimi me nr. 2289 prot., datë 30.12.2010 është konstatuara se:

Pagesa është bërë pas protokollimit të lejës së përdorimit.

Për objektin **“Kompleks vilash rezidenciale me podrum dhe nënçati”**, fshati Mjull Bathore, Komuna Farkë me leje ndërtimi nr. 39, datë 12.01.2007 dhënë nga mbledhja e KRRT-së nr. 8, datë 08.12.2006, me subjekt ndërtues “Vista Group” sh.p.k. me sipërfaqe prone prej 4500 m² dhe sipërfaqe ndërtimi prej 876 m², lëshuar leje përdorimi me nr. 1307 prot., datë 19.06.2012, është konstatuara se:

Pagesa është bërë pas protokollimit të lejës së përdorimi.

Për objektin **“Godinë banimi dhe shërbimi 3,5 kat me podrum dhe nënçati”**, fshati Selitë, Komuna Farkë me leje ndërtimi nr. 3721, datë 28.12.2006 dhënë nga mbledhja e KRRT-së nr. 8, datë 08.12.2006, me subjekt ndërtues **“Lin CONSTRUCTION” sh.p.k.** me sipërfaqe prone prej 1000 m² dhe sipërfaqe ndërtimi prej 450 m², lëshuar leje përdorimi me nr. 1827 prot., datë 02.11.2011, është konstatuara se:

Për objektin **“Vila individuale 2 kat me nënçati dhe podrum”**, fshati Farkë e Madhe , Komuna Farkë” me leje ndërtimi nr. 2248, datë 31.12.2010 dhënë nga mbledhja e KRRT-së nr. 8, datë 16.09.2010,, me subjekt ndërtues **“Niada Projekt” sh.p.k. Investitor “Anarch”**, me sipërfaqe prone prej 501.04 m² dhe sipërfaqe ndërtimi prej 127 m², lëshuar leje përdorimi me nr. 1835 prot., datë 03.11.2011, është konstatuara se:

Aktet e kontrollit nga zyra e urbanistikës janë të pa noterizuara.

Akti i MNZ nga prefektura nuk është origjinal dhe as i noterizuar.

Në të gjitha rastet e lëshimit të lejeve të përdorimit nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 480, datë 22.6.2011, neni 10 “Kushtet për zhvillim”, pika 11 e cila përcakton se “Infrastruktura e nevojshme që mundëson funksionimin e një zhvillimi të ri dhe e lidh zhvillimin e ri me rrjetet ekzistuese të infrastrukturave, realizohet nga zhvilluesi dhe leja e përdorimit jepet vetëm pasi kjo infrastrukturë regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi”, pasi nuk ka certifikatë apo vërtetim pronësor të lëshuar nga ZVRPP Tiranë.

Mungon inventarizimi dhe arkivimi i dosjes në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe rregullorja e nxjerrë në zbatim të tij.

Nga Komuna Farkë, Tiranë me shkresë nr.139/31, prot, datë 20.06.2014, protokolluar në KLSH me nr.52/9 datë 02.07.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Vaso Peci, Piro Imeraj, Jonel Nasto, Ryisim Xhaja, Skënder Hajdari dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT